



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivered	22-12-2020	0	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	3264/2020		115



## Republika e Kosovës

### Republika Kosova – Republic of Kosovo

#### Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A. Nr. 357/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi - kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani - anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A. Nr. 357/2020 të datës 13.11.2020, të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë banimi rruga "Esat Imeri", Tavnik, Komuna e Mitrovicës, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, më datë 22.12.2020, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar Ankesa Nr.357/2020, e datës 13.11.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED]
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr. Protokolli 01-116/01-005637/20 i datës 27.10.2020, i Komisionit Disiplinor të Komunës së Mitrovicës.
- III. Obligohet Komuna e Mitrovicës që ankuesit t'i bëjë kompensimin e pagës në vlerën 20%, e ndalur sipas vendimit Nr. Protokolli 01-116/01-005637/20 të datës 27.10.2020, deri në pranimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.
- IV. Obligohet Kryetar i Komunës së Mitrovicës për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Arsyetim

Ankuesi, [REDACTED], i sistemuar në pozitën e Shefit të Sektorit të Administratës dhe Financave, Drejtoria e Arsimit, në Komunën e Mitrovicës, më datë 13.11.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit Nr. Protokolli 01-116/01-0059637/20 të datës 27.10.2020, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Mitrovicës, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe vendimit të gabuar për shqiptimin e masës disiplinore kundër ankuesit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.11.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës, ndërsa më datë 01.12.2020, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë dhe shkresat e lëndës.

Kolegji për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli A. N. 357/2020 të datës 13.11.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 27.10.2020, i Komisionit Disiplinor; e-maili i datës 13.11.2020; dëshmi për listën e pagave; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën "Zyrtar për listën e pagave për Arsim", Përshkrimi i detyrave të punës, për pozitën "Shef Sektori për Administratë dhe Financa". Kërkesa e datës 28.09.2020, për iniciimin e procedurës disiplinore; Akt Emërimi i datës 22.05.2013; Kontrata e punës e datës 26.02.2015; Kontrata e punës 14.06.2019; Listat e pagave; Procesverbali i datës 07.10.2020 i Komisionit Disiplinor; Procesverbali i datës 16.10.2020 i Komisionit Disiplinor; Vendimi i datës 25.09.2020; Përgjigje në ankesë e datës 01.12.2020, me numër protokolli 2863/2020, me shkresat e bashkangjitura, provat shtesë të datës 21.12.2020.

Kolegji për shqyrtim dhe vendosje të ankesës, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa është e bazuar, sepse:

Kolegji konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet për shqyrtimin e ankesës në kuptim të pranueshmerisë së saj, ashtu siç kërkohet me nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, i cili pretendon se Komisioni Disiplinor i Komunës së Mitrovicës, me Vendimin Nr. Protokolli 01-116/01-005637/20, të datës 27.10.2020, fare nuk ka vërtetuar gjendjen faktike dhe se ankuesi nuk është përgjegjës për shkeljen për të cilin është shpallur fajtor, duke kërkuar nga KPMSHC-ja që të prish vendimin e ankimuar dhe të konstatoj se ankuesi nuk është përgjegjës për çështjen kontestuese.

Kolegji bazuar në Akt Emërimin Nr. Protokolli 01-112-12700 të datës 22.05.2013, ka konstatuar se ankuesi është i sistemuar në pozitën e punës "Shef i Sektorit të Administratës dhe Financave", Drejtoria e Arsimit, në Komunën e Mitrovicës.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës më datë 28.09.2020, ka kërkuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore që të iniciohet procedurë disiplinore ndaj ankuesit, për arsye se ish-Drejtoresha e

Shkollës "Anton Zako Cajupi", [REDACTED], nuk është larguar nga lista e pagave me rastin e përfundimit të mandatit respektivisht përfundimit të marrëdhënies së punës dhe në këtë mënyrë është dëmtuar buxheti i Komunës.

Bazuar në kërkesën e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Komisioni Disiplinor i Komunës së Mitrovicës, ka zhvilluar procedurën disiplinore ndaj ankuesit dhe më datë 27.10.2020 ka nxjerrë Vendim Nr. Protokolli 01-116/01-005637/20, më të cilin ankuesin e ka shpallur fajtor për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 1 dhe 10 të Ligjit Nr. 06/ L-114 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore "Ndalim në pagë për tre muaj në vlerën 20%", sipas nenit 47 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Bazuar në shkresat e lëndës përkatësisht autorizimeve të miratuara nga Kryetari i Komunës, Kolegji ka konstatuar se zyrtari i vetëm i autorizuar për përgatitje të listave të pagave si dhe ndryshimeve në këto lista, është zyrtari për paga, [REDACTED] ndërsa miratues i tyre është Drejtori i Arsimit. Ndërlidhur me këtë konstatim, edhe vet zyrtari i pagave gjatë dëgjimit në procedurë, ka pohuar se ndryshimet në listë të pagave behën vetëm nga ai ndërsa miratimin e bënë vetëm Drejtori i Arsimit. Ankuesi, së bashku me zyrtarin për paga, disa herë kanë komunikuar me ish-drejtorin e Arsimit që të hiqet nga lista e pagave ish-Drejtoresha e Shkollës "Anton Zako Cajupi" [REDACTED], por që ish Drejtori i Arsimit, nuk ka lejuar një gjë të tillë, më arsyetimin që Melihate Meha të mos hiqet nga lista e pagave deri në sistemim në një vend tjetër. Edhe Drejtori i ri i DKA ka refuzuar të bëjë ndryshimin në fjalë, me pretekstin që ai nuk mund të ndreq gabimet e drejtorit të mëhershëm.

Bazuar në shqyrtimin dhe analizimin e shkresave të lëndës, Kolegji ka konstatuar se Komisioni disiplinor nuk ka vërtetuar drejt faktet lidhur me përgjegjësinë disiplinore përkitazi me mos heqjen nga lista e pagave të ish-Drejtoreshës, [REDACTED], dhe se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore kundër ankuesit, nuk janë marrë parasysh të gjitha elementet për vërtetimin e përgjegjësisë disiplinore të ankuesit ashtu siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 45 ku përcaktohet se: *Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.* Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se ankuesi nuk është i autorizuar që të bëjë përgatitjen e listave të pagave e as të bëjë miratimin e tyre, pasi që për këtë detyrë autorizimi i është dhënë zyrtarit për paga nga ana e Zyrtarit me të Lartë Administrativ, respektivisht nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës, ndërsa miratimi final i është dhënë Drejtorit të Arsimit. Nga kjo rrjedh se Komisioni Disiplinor ka dështuar që të vërtetojë përgjegjësit e drejtpërdrejtë lidhur me shkeljet disiplinore që i janë ngarkuar ankuesit, andaj pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Po ashtu Kolegji ka konstatuar se Komisioni Disiplinor nuk ka argumentuar saktë dëmin e shkaktuar si dhe nuk është saktësuar periudha e pagave që i janë paguar Melihate Mehes pas përfundimit të mandatit si drejtoreshë shkolle.

Për kundër faktit së ankuesi nuk është i autorizuar të bëjë ndryshimet në listën e pagave apo miratimin e tyre, Kolegji kolaudon se ankuesi është përgjegjës për menaxhimin e Njesisë së Administratës dhe Financave. Ndërlidhur me këtë konstatim, Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor nuk ka bërë cilësimin e saktë të shkeljes disiplinore dhe se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit nuk ka marrë parasysh të gjitha elementet për individualizimin e masës disiplinore ashtu siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 50 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *"për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit, nga rrjedh se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, nuk është në raport më përgjegjësinë e tij lidhur me shkeljen disiplinore.*

Bazuar në nenin 43 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, procedura disiplinore mund të iniciohet vetëm nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Andaj Kolegji konstaton se Kryetari i Komunës së Mitrovicës ka vepruar në kundërshtim me nenin 43 paragrafi 2 i cili përcakton: *"Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"*

Po nga analizimi i vendimit të Komisionit Disiplinor Nr. Protokollit 01-116/01-005637/20 të datës 27.10.2020, Kolegji konstaton se arsyetimi i vendimit është jo i mjaftueshëm, jo i qartë dhe se nuk përmban të gjitha elementet ashtu siç kërkohet më nenin 48 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton *"Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyeve pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtënjës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.*


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës, i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerret veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda Nr. A. Nr. 357/2020


Rushit KAJTAZI

  
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj - DEMI



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit 
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

